



Përshkrimi i projektit

Projekti adreson nevojat e vendeve të Ballkanit në lidhje me përdorimin e gurit, një burim natyror, i cili është mjaft i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë në vendet mesdhetare. Egzistojnë një sërë problemesh të evidentuara në këtë industri sot, të cilat përfshijnë:

- çmimet e larta të nxjerrjes së gurit për shkak të makinerive dhe teknikave të vjetra,
- mungesën e cilësisë në produkte nga përdorimi i tepërt i eksplozivëve për nxjerrjen e tij, çfarë e bën gurin të ndahet lehtësisht kur vendoset në destinacionin përfundimtar, dhe të shkaktojë probleme sigurie për punëtorët,
- numrin e madh të aksidenteve në gurore për shkak të përdorimit të eksplozivëve, në vend të makinerive moderne të ndërtruara me tela diamanti;
- ndikimi i mjedisit të ndotur për shkak të pluhurit apo baltës në gurore.



Objektivi i përgjithshëm i projektit


Projekti BKSTONE ka si qëllim kryesor nxitjen e modernizimit dhe zhvillimit të sektorit të gurit në vendet partnere të Ballkanit Perëndimor përmes forcimit të marrëdhënies midis institucioneve të arsimit të lartë dhe industrisë, si dhe ndërkombëtarizimit të kurrikulës dhe metodave.

Objektivat specifike

- Të kontribuojë përmes rezultateve të projektit për të zhvilluar strategji kombëtare / rajonale të inovacionit për specializim në sektorin e gurit natyror.
- Të vlerësohen pikat e forta të secilit vend / rajon, avantazhet konkurruese dhe potenciali i përsosmërisë në sektorin e gurit përmes krahasimit të iniciativave ekzistuese të trajnimit dhe përfshirjes së elementeve në

materialët arsimore që do të zhvillohen në projekt.

- Të mbështesë trajnime inovative teknologjike, si dhe praktike të bazuara në qasjen dhe formatin e kurseve që do të zhvillohen.
- Të kontribuojë për të përfshirë plotësisht palët e interesit në industrinë e gurit, duke inkurajuar pjesëmarrjen e tyre në fazat e konceptimit dhe testimit të zhvillimit të materialeve.
- Të promovojë midis studentëve të mësuarit aktiv dhe konstruktiv si një mjet i domosdoshëm për të punuar në sektorin e gurit, duke testuar mundësi të reja në vendet partnere si studimet 2-vjecare profesionale .
- Krijimi i një platforme rrjeti që përfshin përfaqësuesit e sektorit të gurit, Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) dhe organizatat VET të programit të BE dhe vendeve partnere bazuar në zbatimin e plotë të projektit.



BASHKEPUNETOR LOKAL: BUCI SHPK



CONSORTIUM

- Universiteti politeknik i Tiranës
- Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan
- Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë
- Universiteti “Hasan Prishtina”, Prishtinë
- Kolegji kombëtar për Biznes dhe Teknologji, Shqipëri
- Universiteti i Sarajevës
- Universiteti i Mostar-it, Bosnia and Herzegovina
- Universiteti Mesdhetar i Podgoricës
- “Xunta de Galicia” Spanjë
- Universiteti i Corunës, Spanjë
- “Scuola Edile Padova”, Itali
- “Sapienza Università da Roma”, Itali
- “National Technical University of Athens”, Greqi
- “Trasilvania University of Brasov”, Rumani
- Centro Tecnológico del marmol, piedra y materials, Spanjë



HIGHER EDUCATION ENTERPRISE FOR FOSTERING, MODERNIZATION AND SUSTAINABLE GROWTH IN NATURAL STONE INDUSTRY IN WESTERN BALKANS



<https://bkstoneproject.com/projects/>